



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-025

Prishtinë, më 12 korrik 2011, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 12 KORRIK 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini dhe Rasim Demiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Bilall Sherifi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 5 korrik 2011,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur 5 korrik 2011

Kryesia miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 5 korrik 2011.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi t'i mbajë dy mbledhje të radhës, si vijon:

Më 14 korrik 2011, mbledhja plenare e jashtëzakonshme me këtë:

R e n d d i t e

- Debat parlamentar lidhur me dialogun e Qeverisë të Republikës së Kosovës me Republikën e Serbisë dhe marrëveshjet e arritura në këtë dialog, sipas kërkesës së GP LDK, GP LVV dhe GP AAK.

Më 21 korrik 2011, mbledhja plenare me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritet,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për themelimin e regjistrit të drejtave të pronës së paluajtshme,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe të pasurisë së tyre,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rregullimin e tokës,
14. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2010.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave:

3.1 Kërkesa e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut për përkrahje financiare

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet ndihma financiare Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, në shumën prej 3.000 euro, për vazhdimin e qëndrueshëm të punës monitoruese të Këshillit për një periudhë gjashtëmujore.

3.2 Shqyrtimi i Propozim - Vendimit të Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozim Vendimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë Propozim-Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.3 Kërkesa e Komisionit për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i anëtarëve të Komisioni për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në këtë përbërje: Haki Demolli, Halit Krasniqi, Imri Ahmeti, Blerim Shala, Amir Ahmeti, Enis Kervan, Albulena Haxhiu, Jasmina Zivković, Teuta Sahatqija, Behar Selimi dhe Armend Zemaj, si dhe i stafit mbështetës Xheladin Hoxha dhe Mirjeta Heta, në Shqipëri, prej datës 11 deri me 14 korrik 2011.

2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit, për të lartpërmendurit në paragrafin (1) të këtij vendimi, i bartë organizatori - OSBE-ja, ndërsa mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

Pika shtesë:

1. Kërkesa e EULEX-it që Kuvendi të miratojë një Rezolute me të cilën kërkohet nga Qeveria që të referojë çështjen e imunitetit në Gjykatën Kushtetuese

Kryetari i njoftoi të pranishmit me përmbajtjen e shkresës të shefit të EULEX-it, z. Xavier Bout de Marnhac, lidhur me kërkesën për të referuar në Gjykatën Kushtetuese çështjen e imunitetit të deputetëve të Kuvendit. Gjithashtu, kryetari i njoftoi të pranishmit edhe me shkresën që ai e kishte përgatitur për shefin e EULEX-it, z. Xavier Bout de Marnhac lidhur me kërkesën e cekur më lart.

Lidhur me këtë çështje diskutuan: kryetari Jakup Krasniqi, nënkryetarët: Glauk Konjufca dhe Sabri Hamiti, si dhe kryetarët e GP: Adem Grabovci, Ardian Gjini, Ismet Beqiri dhe Visar Ymeri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën 11:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.